

Termat dhe kushtet për prenotimin

Përdorimi i shërbimeve të Easy Market nënkupton pranimin e Kushteve të Përgjithshme dhe Shkresës Informuese nga ana e Përdoruesit lidhur me Ruajtjen e privatësisë së përmendur këtu.

Përmbajtjet dhe përdorimi i faqes së internetit Easy Market.

Prenotimi dhe blerja e produkteve dhe shërbimeve të pranishme në faqen e internetit të **Easy Market** rregullohet nga kushtet kontraktore të aplikuara nga furnitorët e vet produkteve dhe shërbimeve. Çdo përdorues duhet të jetë në dijeni dhe të pranojë këto Kushte të Përgjithshme përpara se të procedojë me prenotimin dhe / apo blerjen.

Mbledhja, trajtimi dhe çdo veprim tjetër lidhur me informacionet e dhëna gjatë procesit të blerjes bëhet në përputhje me Shkresën Informuese rreth Privatësisë, pjesë përbërëse e Kushteve të Përgjithshme. Përdoruesi zotohet të përdorë **Easy Market**, funksionet dhe shërbimet e saj, ekskluzivisht për qëllime të lejuara nga ligji, në respekt të Kushteve të Përgjithshme dhe të Kushteve Kontraktore që rregullojnë ofrimin e shërbimeve.

Lidhje me faqe interneti të tjera nga Easy Market.

Easy Market përmban lidhje me faqe interneti të partnerëve tanë tregtarë, pra të palëve të treta. Publikimi i faqeve (Linke) të mbivendosura në tekst mbi Easy Market bëhet për qëllime informuese dhe si referim për lundrimin e përdoruesve dhe nuk përfshin asnjë njohje apo pranim të kësaj faqeje apo përmbajtjes së saj nga ana e Easy Market. Easy Market, nuk ushtron asnjë kontroll mbi përmbajtjet, informacionet apo shërbimet dhe / apo produktet e ofruara nga këto faqe ndërlidhëse dhe nuk merr asnjë përgjegjësi lidhur me vërtetësinë e tyre, përkujdesjen dhe përditësimin e informacioneve të publikuara në këto faqe të ndërlidhura. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, publikimi tek Easy Market i një ndërlidhjeje mbitekstore me një burim interneti tjetër nuk nënkupton ekzistencën e ndonjë lidhjeje apo përkatësie tregtare mes Easy Market dhe administratorëve të faqes ndërlidhëse.

Easy Market nuk përgjigjet në asnjë rast për detyrimet që janë barrë e furnitorëve të secilit produkt dhe / apo shërbim, por është përgjegjës ekskluzivisht për ato që rrjedhin nga cilësia e vet si ndërmjetës dhe gjithsesi me kufizimet e parashikuara nga ligji Nr. 93/2015 “Për turizmin”, ligj i cili është në përputhshmëri të pjesshme me nenin 2, nenin 3, si dhe me kuadri ligjor i Aneksit të Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE të 13 qershorit 1990, “Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve” dhe Ligjin nr.9902, dt.17.04.2008 “Për mbrojtjen e

konsumatorëve”, i ndryshuar, Vendimi nr.65, datë 21.1.2009 “*Për kontratat e paketave të udhëtimit*” dhe LIGJI Nr.10 089, datë 2.3.2009 për aderimin e republikës së shqipërisë në konventën “*Për lehtësitë doganore për turizmin*”.

Informuese rreth Ruajtjes së Privatësisë

Të dhënat personale të lëshuara nga përdoruesit në **Easy Market**, do të regjistrohen elektronikisht në mënyrë të mbrojtur nga serverat tanë dhe do të përdoren në respekt të dispozitave të **ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”**, (kodi në lëndën e ruajtjes së të dhënave personale) sipas parimeve të korrektësisë, ligjshmërisë dhe transparencës.

Të dhënat personale të përdoruesve trajtohen pas autorizimit.

1. Titullari i trajtimit të të dhënave është **Easy Market sh.a.**
2. Të dhënat personale do të përdoren nga ana jonë ekskluzivisht për qëllimet e mëposhtme:
 - Ofrimin e shërbimeve tona tek klientët;
 - Përcjelljen e të dhënave personale të Përdoruesit tek ofrues të tretë shërbimi, në momentin e prenotimit apo të blerjes së shërbimit të udhëtimit nëpërmjet Agjentit të udhëtimit përkatës;
 - Informimin e përdoruesit rreth shërbimeve të reja dhe produkteve që mund t'i interesojnë;
 - Personalizimin e lajmërimeve publicitare drejtuar Përdoruesit.
3. Përdoruesi bie dakord se **Easy Market** mund të përcjellë të dhënat e tij personale tek palë të treta vetëm nëse kërkohet nga ligji apo nëse ky veprim është i nevojshëm për:
 - Të respektohet kuadrin ligjor apo procedurat ligjore të përdorura në Easy Market apo në faqen e internetit;
 - Të ndërhyrë urgjentisht, nëse rrethanat e kërkojnë diçka të tillë, për ruajtjen e sigurisë personale të përdoruesve të easy Market, për faqen apo për publikun.
4. Në çdo moment, në përputhje me sa parashikohet nga **neni 12 dhe 13 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, të ndryshuar**, Klienti ka të drejtë që të:
 - Dijë të dhënat e tij personale në posedim nga Easy Market si dhe mënyrën e trajtimit të këtyre të dhënave;
 - Përditësojë, plotësojë, ndryshojë apo korrigjojë të dhënat personale;
 - Kërkojë ndërprerjen e çdo trajtimi të të dhënave personale që shkel ligjin;

- Ndalojë trajtimin e të dhënave personale për arsye të justifikuara apo, gjithsesi, kur trajtimi i drejtohet mbledhjes së informacioneve tregtare, dërgimit të publicitetit, shitjes direkte apo kërkimeve të tregut, duke kontaktuar Titullarin e Trajtimit të të dhënave në adresën: info@easymarketers.it.

Easy market përdor rrjete të dhënash të mbrojtura si dhe merrë masat e duhura të sigurisë për ruajtjen kundër dëmeve, përdorimit jo të duhur si dhe ndryshimit të të dhënave të përdoruesit në posedim të saj. Nëpunësit e **Easy Market** duke pasur akses në banka të dhënash që memorizojnë informacionet mbi përdoruesit apo në servera që mbajnë shërbimet tona, duhet të respektojnë rigorozisht rregullat.

Copyright

Kjo faqe interneti është e destinuar për përdorim vetjak nga ana e përdoruesit. Nuk mund të ndryshohet, riprodhohet, duplikohet, kopjohet, shpërndahet, shitet, rishitet, apo të shfrytëohet në asnjë mënyrë tjetër për qëllime komerciale. Është gjithashtu e ndaluar të përdoret kjo faqe interneti për çdo qëllim të paligjshëm apo të ndaluar.

Këto kushte mund të ndryshohen nga **Easy Market** në çdo kohë.

Termet dhe kushtet: Fluturimet e linjës

Easy Market vepron ekskluzivisht si ndërmjetësues produktesh dhe / apo shërbimesh.

Easy Market informon agjentin e udhëtimit se kryen ekskluzivisht ndërmjetësuesin e shërbimit të fluturimeve të linjës që nuk konsiderohet si rast negociale organizimit të paketave turistike dhe disiplinohet nga termet dhe kushtet e çdo shërbimi të veçantë që është objekti kontratës si më poshtë **si dhe e fton të konsultojë me kujdes kushtet e transportit për pasagjerët dhe bagazhet e kompanisë ajrore të përzgjedhur.**

Prenotimi dhe / apo kombinimi i fluturimeve dhe produkteve apo shërbimeve të ndryshme të ofruara nga **Easy Market** është diskrecion tërësisht i klientit përfundimtar, i cili merr çdo përgjegjësi që rrjedh nga kombinimi i tyre.

Easy Market nuk përgjigjet në asnjë rast lidhur me gabimet në futjen e të dhënave personale nga ana e klientëve bërë gjatë procesit të blerjes.

Klienti është përgjegjës për pasojat që rrjedhin nga futja e gabuar e këtyre të dhënave.

Në fakt, në rastin e produktit FLUTURIME, **Easy Market** vepron si ndërmjetësues mes kompanive ajrore në shitjen e biletës së avionit.

Tarifa nuk konfirmohet që nga prerja e biletës së avionit. **Easy Market**

Easy Market nuk përgjigjet në asnjë rast për detyrimet që janë barrë e furnitorëve të secilit produkt dhe / apo shërbim, por është përgjegjës ekskluzivisht për atë që rrjedhin nga cilësia e vet si ndërmjetës dhe gjithsesi në kufizimet e parashikuara nga ligji Nr. 93/2015 “Për turizmin”, ligji i cili është në përputhshmëri të pjesshme me nenin 2, nenin 3, si dhe me kuadri ligjor i Aneksit të Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE të 13 qershorit 1990, “Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve” dhe Ligjin nr.9902, dt.17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar lidhur me të drejtat e konsumatorit, lidhur shërbimin e transportit të pasagjerëve.

Easy Market në cilësinë e ndërmjetësuesit të udhëtimeve, nuk përgjigjet për mospërmbushjen totale apo të pjesshme të udhëtimit, qëndrimit apo produkteve të tjera dhe / apo shërbimeve që janë objekt i kontratës së nënshkruar mes klientit dhe furnitorit lidhur me produktet dhe / apo shërbimet. Agjencitë e udhëtimit deklarojnë dhe garantojnë ta mbajnë të padëmtuar dhe të dëmshpërblejnë kompaninë Easy Market, si dhe subjektet e lidhura me të dhe të kontrolluar prej saj, përfaqësuesit e saj, vartësit, bashkëpunëtorët, si dhe partnerët për çdo detyrim për t’u shlyer, përfshirë shpenzimet ligjore, që mund të lindin në ngarkim të tyre lidhur me përdorimin e produkteve dhe / apo shërbimeve të blera në faqen e internetit.

Taksa e bagazheve nuk garantohej asnjëherë nga Easy Market dhe duhet të verifikohet gjithnjë drejtpërdrejt me kompaninë ajrore, e cila, në diskrecionin e saj, mund të mos e përfshijë në tarifën e biletës. Në këtë rast do të jetë e nevojshme të verifikohet me vet vektorin se si ta imbarkojë bagazhin në stivë. Autorizimi dhe dispozitat do të varen nga kompania ajrore. Sipas ligjit, agjencitë e udhëtimit dëmshpërblejnë Easy Market për vonesat e mundshme, dëmet apo humbjet e lidhura me transportet, anulimet e fluturimeve apo të papritura të tjera të pakëndshme që varen nga kompanitë ajrore edhe në bazë të Rregullores 261/04/EC të Parlamentit Evropian që vendos rregulla të përbashkëta në lëndën e kompensimit dhe asistencës së pasagjerëve në rast moslejimi për imbarkim, anulimi fluturimi dhe vonesash të tejzgjatura.

Informacione të pranishme në faqen e internetit

Ndërmjetësuesi zotohet të kryejë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar që informacionet e përmbajtura në faqen e internetit dhe të lidhura me shërbimet e kompanive ajrore të jenë të kujdesshme dhe të përditësuara. Gjithsesi, informacionet e përmbajtur në faqen e internetit ofrohen nga palë të treta. Për këtë arsye, në kufij të asaj çka lejohet nga kuadri ligjor në fuqi, ndërmjetësuesi nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përmbajtjen dhe saktësinë e tyre.

Dokumentat e udhëtimit

Është detyrim i agjentit të udhëtimit të sigurojë që përdoruesi të jetë në posedim të dokumenteve të identitetit, vizave dhe kushteve shëndetësore të vlefshme dhe të nevojshme për të hyrë në

vendet objekt të itinerarit, është përgjegjësi e saj ekskluzive të respektojë të gjithë ligjet dhe rregulloret e Shteteve të nisjes, të tranzitit apo mbërritjes. Easy Market heq dorë nga çdo përgjegjësi për mospërbushje të një apo disa për këtyre kushteve. Në fazë prenotimi është e nevojshme të tregohet kujdes i veçantë për plotësimin e hapësirave lidhur me emrin dhe mbiemrin e pasagjerëve, të cilat duhet të përputhen saktësisht me ato që përmban dokumenti i identifikimit personal. Vektori në fakt, mund të pranojë dhe të imbarkojë vetëm pasagjerin emri i të cilit qëndron në biletë. Nuk ka të drejta as rimbursim në rast se mohohet imbarkimi në bordin e avionit për mosparaqitje të dokumenteve të kërkuar apo të jenë paraqitur të tillë të pavlefshëm. Pasagjeri është i vetmi person përgjegjës për posedimin e dokumentacionit të nevojshëm. Për informacionet mbi dokumentat e kërkuar për hyrjen në vende të ndryshme sugjerojmë të këshillohet faqja **Ministero degli Affari Esteri (Ministria e Punëve të Jashtme)**.

Paraqitja për tërheqjen e biletës, pranimin dhe imbarkimin

Për tërheqjen e biletës dhe për kryerjen e formaliteteve të pranimin në kohën e duhur, pasagjeri duhet të paraqitet drejtpërdrejt në sportelin e pranimin të aeroportit, i pajisur me dokumentacionin e rregullt, të vlefshëm për imbarkimin. Këshillohet paraqitja në sportelin e check-in-it të paktën 2,5 orë përpara nisjes së avionit për kryerjen e formaliteteve të fluturimit. Përfshihen pasagjerët që kalojnë tranzit apo shkojnë në SHBA, për të cilët është e nevojshme të paraqiten në aeroport të paktën 3 orë përpara nisjes së avionit dhe të paraqiten në kohë në dalje të imbarkimit. Prenotimi ka të përcaktuar dhe orën e nisjes së avionit; nëse përdoruesi nuk paraqitet në kohën e duhur në sportelin e pranimin apo të daljes për imbarkim, apo rezulton të mos jetë në posedim të dokumentacionit të nevojshëm apo nuk është në gjendje të niset, kompania ajrore nuk do të pranojë në asnjë rast të imbarkojë klientin dhe gjithsesi nuk do të vonojë nisjen e fluturimit. Easy Market nuk mban përgjegjësi lidhur me sa më sipër, duke qenë se i vetmi përgjegjës për sa më sipër apo dëme të mundshme të shkaktuar nga pakujdesia, është pasagjeri.

Bileta elektronike (e-ticketing)

Bileta elektronike përcillet automatikisht tek kompania ajrore dhe identifikohet nëpërmjet një kodi prenotimi të përcaktuar PNR (Passenger Name Record), i cili do t'i komunikohet në momentin e konfirmimit të prenotimit nëpërmjet marrjes së një e-mail-i konfirmimi në adresën e dhënë nga klienti gjatë fazës së prenotimit.

Ndryshimet dhe Anullimet

Në rast nevojë për ndryshime apo anulime të biletës së avionit, përdoruesi drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet agjencisë së udhëtimit, duhet t'i komunikojë kërkesën kompanisë Easy Market, duke

dërguar një e-mail në voli@easymarketers.it. Pasi arrihet komunikimi, zyra kompetente do të verifikojë nëse për biletën e avionit të blerë lejohen ndryshime apo anulime, sipas rregullave tarifore të komunikuara në momentin e blerjes së biletës nga ana e kompanisë ajrore.

Në rast se po, do të komunikohen penalitetet e aplikuara nga kompania ajrore, përveç një përshtatjeje të mundshme tarifore. Biletat janë dokumenta nominativë dhe nuk u transferohen të tretëve. Nëse emri i pasagjerit nuk është i saktë, mund të jetë e nevojshme të anulohet prenotimi apo të blihet një biletë e re. Disa prenotime nuk mund të ndryshohen. Easy Market nuk mban asnjë përgjegjësi për hyrjen e gabuar të një emri.

Anullimi i një bilete brenda ditës dhe zëvendësimi me një PNR tjetër:

Është përgjegjësi e klientit përfundimtar drejtpërdrejt apo nëpërmjet kompanisë së udhëtimit, të verifikojë me booking voli (prenotimi i fluturimeve) të Easy Market mundësinë e anulimit të fluturimit pa penalitete. Në rast përgjigjeje pozitive nga ana e booking Voli, konsiderohet e nevojshme të rezervohet një PNR tjetër (me tarifën dhe kushtet e disponueshme nga sistemi në momentin e prenotimit) dhe njëkohësisht të kërkojë nxjerrjen e një PNR-je të re. Për këtë qëllim agjencia e udhëtimit duhet të shënojë këtë citim “**Kërkoj anulimin e këtij PNR...**” duke shënuar PNR-në e vjetër të prenotimit që duhet anuluar. Anullimi mund të kërkohet edhe me anë të e-mail-it. Verifikoni nëse keni marrë përgjigjen e kërkesës suaj (nëpërmjet e-mailit) me konfirmimin e anulimit, për të qenë të sigurtë se PNR ka “Fluturuar” d.m.th. nuk është më efektive. Është e rëndësishme të respektohet procedura e mësipërme me qëllim që të shmangen gabime të mundshme.

Rimbursimet

Autorizimi për rimbursim dhe afatet përkatëse i përkasin ekskluzivisht kompanisë ajrore, e cila ka kohë maksimumi deri në 12 muaj nga kërkesa për të proceduar me kreditimin. Nëse pagesa është bërë me anë të kartës së kreditit, shuma do të rimbursohet drejtpërdrejt në kartën e kreditit të përdorur për të bërë porosinë. Nëse pagesa është bërë nëpërmjet bankës (e mundshme vetëm për Hotelet), Agjencia do të kontaktohet nga shërbimi ynë i klientit, për komunikimin e koordinatave bankare për të kryer rimbursimin. Saktësohet se të drejtat e agjencisë dhe siguracioni përkatës nuk janë kurrë të rimbursueshme.

Përdorimi i linjave të fluturimit

Linjat e fluturimit nuk duhet të përdoren në mënyrë të njëpasnjëshme, mospërdorimi i njërës prej linjave mund të sjellë anulimin e menjëhershëm të itinerarit të udhëtimit pa mundësi rimbursimi të biletës.

Kërkesa shtesë

Çdo kërkesë shtesë, si imbarkim kafshësh, kërkesë për pasagjerë me lëvizhmëri të ngadaltë, imbarkim armësh, pajisjesh sportive, fëmijë të mitur dhe të pashoqëruar dhe çdo imbarkim tjetër të veçantë mund të njoftohet në fazën e prenotimit apo të kërkesës për prerjen e biletës. Për çdo rast, nevoja e shprehur nga ana juaj do i dërgohet vektorit vetëm në aktin e kërkesës së prerjes së biletës. I takon kompanisë ajrore, në bazë të kushteve dhe disponibilitetit të saj, të vendosë nëse do e konfirmojë apo jo shërbimin e dëshiruar. Përpara se të procedohet me prerjen e biletës, Easy Market duhet të presë përgjigjen e vektorit, bileta do të pritët vetëm pas rikonfirmimit nga ana e këtij të fundit. Në disa raste vektori mund të paguajë detyrime shtesë drejtpërdrejt në aeroport. Në rast se nuk është e mundur të konfirmohet kërkesa, Easy Market do të marrë masa për t'ju lajmëruar përpara se të pritët bileta, pra mund të zgjidhni nëse do të konfirmoni prerjen e biletës apo do të kërkonin anulimin e prenotimit.

Fëmijët e mitur të pashoqëruar

Çdo kompani ajrore aplikon procedurat dhe rregullat vetjake përsa i përket fëmijëve të mitur të pashoqëruar.

Termet dhe kushtet: Fluturimet e Low Cost

Easy Market vepron ekskluzivisht si ndërmjetësues produktesh dhe / apo shërbimesh.

Easy Market informon agjentin e udhëtimit se kryen ekskluzivisht ndërmjetësuesin e shërbimit të fluturimeve të linjës që nuk konsiderohet si rast negociale i organizimit të paketave turistike dhe disiplinohet nga termet dhe kushtet e çdo shërbimi të veçantë që është objekt i kontratës si më poshtë **si dhe e fton të konsultojë me kujdes kushtet e transportit për pasagjerët dhe bagazhet të kompanisë ajrore të përzgjedhur.**

Prenotimi dhe / apo kombinimi i fluturimeve dhe produkteve apo shërbimeve të ndryshme të ofruara nga **Easy Market** është diskrecion tërësisht i klientit përfundimtar, i cili merr çdo përgjegjësi që rrjedh nga kombinimi i tyre.

Easy Market nuk përgjigjet në asnjë rast lidhur me gabimet në futjen e të dhënave personale nga ana e klientëve bërë gjatë procesit të blerjes.

Klienti është përgjegjës për pasojat që rrjedhin nga futja e gabuar e këtyre të dhënave.

Në fakt, në rastin e produktit FLUTURIME, **Easy Market** vepron si ndërmjetësues mes kompanive ajrore në shitjen e biletës së avionit.

Tarifa nuk konfirmohet që nga prerja e biletës së avionit.

Easy Market nuk përgjigjet në asnjë rast për detyrimet që janë barrë e furnizuesëve të sejcilit produkt dhe/apo shërbim por është përgjegjës ekskluzivisht për atë që rrjedhin nga cilësia në

rolin e ndërmjetësit dhe gjithësi në kufizimet e parashikuara nga ligji Nr. 93/2015 “Për turizmin”, ligj i cili është në përputhshmëri të pjesshme me nenin 2, nenin 3, si dhe me kuadri ligjor i Aneksit të Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE të 13 qershorit 1990, “Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve” dhe Ligjin nr.9902, dt.17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar lidhur me të drejtat e konsumatorit, lidhur shërbimin e transportit të pasagjerëve.

Easy Market në cilësinë e ndërmjetësuesit të udhëtimeve, nuk përgjigjet për mospërbushjen totale apo të pjesshme të udhëtimit, qëndrimit apo produkteve të tjera dhe / apo shërbimeve që janë objekt i kontratës së nënshkruar mes klientit dhe furnizuesit lidhur me produktet dhe / apo shërbimet. Agjencitë e udhëtimit deklarojnë dhe garantojnë ta mbajnë të padëmtuar dhe të dëmshpërblejnë kompaninë Easy Market, si dhe subjektet e lidhura me të dhe të kontrolluara prej saj, përfaqësuesit e saj, vartësit, bashkëpunëtorët, si dhe partnerët për çdo detyrim për t’u shlyer, përfshirë shpenzimet ligjore, që mund të lindin në ngarkim të tyre lidhur me përdorimin e produkteve dhe / apo shërbimeve të blera në faqen e internetit.

Taksa e bagazheve nuk garantohet asnjëherë nga Easy Market dhe duhet të verifikohet gjithnjë drejtpërdrejt me kompaninë ajrore, e cila, në diskrecionin e saj, mund të mos e përfshijë në tarifën e biletës. Në këtë rast do të jetë e nevojshme të verifikohet me vet vektorin se si ta imbarkojë bagazhin në stivë. Autorizimi dhe dispozitat do të varen nga kompania ajrore. Sipas ligjit, agjencitë e udhëtimit dëmshpërblejnë Easy Market për vonesat e mundshme, dëmet apo humbjet e lidhura me transportet, anulimet e fluturimeve apo të papritura të tjera të pakëndshme që varen nga kompanitë ajrore edhe në bazë të Rregullores 261/04/EC të Parlamentit Evropian që vendos rregulla të përbashkëta në lëndën e kompensimit dhe asistencës së pasagjerëve në rast moslejimi për imbarkim, anulimi fluturimi dhe vonesash të tejzgjatura.

Informacione të pranishme në faqen e internetit

Ndërmjetësuesi zotohet të kryejë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar që informacionet e përmbajtura në faqen e internetit dhe të lidhura me shërbimet e kompanive ajrore të jenë të kujdesshme dhe të përditësuara. Gjithësi, informacionet e përmbajtuara në faqen e internetit ofrohen nga palë të treta. Për këtë arsye, në kufij të asaj çka lejohet nga kuadri ligjor në fuqi, ndërmjetësuesi nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përmbajtjen dhe saktësinë e tyre.

Dokumentet e udhëtimit

Është detyrim i agentit të udhëtimit të sigurojë që përdoruesi të jetë në posedim të dokumenteve të identitetit, vizave dhe kushteve shëndetësore të vlefshme dhe të nevojshme për të hyrë në vendet objekt të itinerarit, është përgjegjësi e saj ekskluzive të respektojë të gjitha ligjet dhe

rregulloret e Shteteve të nisjes, të tranzitit apo mbërritjes. Easy Market heq dorë nga çdo përgjegjësi për mospërbushje të një apo disa prej këtyre kushteve. Në fazën e prenotimit është e nevojshme të tregohet kujdes i veçantë për plotësimin e hapësirave lidhur me emrin dhe mbiemrin e pasagjerëve, të cilat duhet të përputhen saktësisht me ato që përmban dokumenti i identifikimit personal. Vektori në fakt, mund të pranojë dhe të imbarkojë vetëm pasagjerin, emri i të cilit gjendet në biletë. Nuk ka të drejta as për rimbursim në rast se mohoet imbarkimi në bordin e avionit për mosparaqitje të dokumentave të kërkuara apo të jenë paraqitur të tillë si të pavlefshëm. Pasagjeri është i vetmi person përgjegjës për posedimin e dokumentacionit të nevojshëm. Për informacionet mbi dokumentat e kërkuara për hyrjen në vende të ndryshme sugjerojmë të këshillohet faqja **Ministero degli Affari Esteri (Ministria e Punëve të Jashtme)**.

Paraqitja për tërheqjen e biletës, pranimin dhe imbarkimin

Për tërheqjen e biletës dhe për kryerjen e formaliteteve të pranimit në kohën e duhur, pasagjeri duhet të paraqitet drejtpërdrejt në sportelin e pranimit të aeroportit, i pajisur me dokumentacionin e rregullt, të vlefshëm për imbarkimin. Këshillohet paraqitja në sportelin e check-in-it të paktën 2,5 orë përpara nisjes së avionit për kryerjen e formaliteteve të fluturimit. Përfshihen pasagjerët që kalojnë tranzit apo shkojnë në SHBA, për të cilët është e nevojshme të paraqiten në aeroport të paktën 3 orë përpara nisjes së avionit dhe të paraqiten në kohë në daljet e imbarkimit. Prenotimi ka të përcaktuar dhe orën e nisjes së avionit; nëse përdoruesi nuk paraqitet në kohën e duhur në sportelin e pranimit apo të daljes për imbarkim, apo rezulton të mos jetë në posedim të dokumentacionit të nevojshëm apo nuk është në gjendje të nisjet, kompania ajrore nuk do të pranojë në asnjë rast të imbarkojë klientin dhe gjithsesi nuk do të vonojë nisjen e fluturimit. Easy Market nuk mban përgjegjësi lidhur me sa më sipër, duke qenë se i vetmi përgjegjës për sa më sipër apo dëme të mundshme të shkaktuar nga pakujdesia, është pasagjeri.

Check-in online

KUJDES: Disa kompani ajrore low cost, parashikojnë check-in online të detyrueshëm, që duhet kryer nëpërmjet faqes së internetit të vektorit ajror, brenda një afati të vendosur paraprakisht nga data e nisjes. Pasagjerët që nuk do të paraqesin kartën e imbarkimit, të printuar online, tek personeli i sigurisë së aeroportit apo në portën e imbarkimit, duhet të bëjnë sërish check-in në sportelin e aeroportit (në rast se është e mundur) dhe do të jenë subjekte të cilëve do u debitet një tarifë suplementare e vendosur gjithnjë nga kompania ajrore. Kompanitë që parashikojnë check-in online të detyrueshëm, për momentin janë si më poshtë vijon: Ryanair, Volotea, Wizz Air dhe Blumarine.

Bileta elektronike (e-ticketing)

Bileta elektronike përcillet automatikisht tek kompania ajrore dhe identifikohet nëpërmjet një kodi prenotimi, të përcaktuar PNR (Passenger Name Record), i cili do t'i komunikohet në momentin e konfirmimit të prenotimit nëpërmjet marrjes së një e-maili konfirmimi në adresën e dhënë nga klienti në fazën e prenotimit.

Prerja e biletës

Zakonisht kompanitë low cost përdorin biletën elektronike. Kjo do të thote se nuk do të printohet anjë biletë në letër por pasi të përfundojë prenotimi juaj, do t'ju dërgohet një e-mail konfirmimi, ku do të theksohet numri i prenotimit të fluturimit tuaj low cost. Lutemi ta printoni dhe ta paraqisni bashkë me dokumentin tuaj të identitetit, në momentin e check-in-it. Theksohet se, për të gjithë fluturimet e Ryanair, është e detyrueshme të bëhet check-in online, direkt në faqen e internetit Ryanair dhe të printohet karta e imbarkimit, që duhet paraqitur në aeroport, për këtë arsye lutemi të shihet më kujdes kjo faqe e fundit, lidhur me afatin kohor brenda së cilit është e detyrueshme të bëhet printimi i kartës së imbarkimit, duke qenë se parashikohet një penalitet në ngarkim të konsumatorit, nga ana e kompanisë ajrore në rast tejkalimi të afatit.

Debitimi i biletës

Ju informojmë se debitimi i biletës së avionit do të bëhet me dy transaksione të ndryshme. Kompania ajrore do të kujdeset për debitimin e biletës (tarifa e biletës, taksat aeroportuale, tarifa për bagazhin e stivës dhe pagesa shtesë të mundshme për debitimin e kartës) ndërsa Easy Market në cilësinë e ndërmjetësuesit, do të kujdeset për debitimin e taksës së shërbimit të siguracionit të udhëtimit fakultative (nëse kërkohet). Në pasqyrën financiare të llogarisë, do shikoni dy debitime të ndryshme por shuma e të dyjave korrespondon saktësisht me shumën totale të sakëtsuar në e-mail-in tuaj të konfirmimit.

Anullimet

Zakonisht të gjitha biletat low cost nuk janë të rimbursueshme përveç rasteve kur kompania ajrore anulon apo ndryshon orarin e nisjes në mënyrë domethënëse. Për informacione të mëtejshme lutemi të konsultoni termat dhe kushtet e secilit vektor. U këshillohet pasagjerëve që prenotojnë përpara kohe, të konfirmojnë prenotimin mes 24 dhe 72 orësh përpara nisjes, duke hyrë direkt në faqen e internetit të kompanisë ajrore në hapësirën e seleksionuar.

Ndryshim i emrit

Ndryshimet janë të lejuara pas pagimit të një takse penaliteti, vendosur nga vektori low cost, plus pagesës së diferencës mes tarifës fillestare të pagesës së paguar dhe tarifës minimale të

disponueshme në momentin e ndryshimit. Në çdo rast, ndryshimi i emrave duhet t'i kërkohet direkt kompanisë ajrore low cost.

Rregullat e sigurisë për bagazhet e dorës

Nga data 6 nëntor 2006, Bashkimi Evropian ka përdorur rregulla të reja sigurie, të cilat kufizojnë sasinë e substancave të lëngshme të lejuara, për të kaluar pikat e kontrollit të sigurisë së aeroportit. Pasagjerët mund të transportojnë vetëm sasi të vogla (maksimumi 100 ml për kontenitor) lëngje, xhel, kremra dhe përmbajtje të gazta në bagazhin e dorës dhe duhet të transportohen në një qese plastike transparente që nuk mund ta kalojë një litër (psh. me dimensione të barabarta me rreth 18 x 20 cm). Mund të transportohen jashtë qeses dhe nuk kufizohen në volum, medikamentet dhe lëngjet e përshkruara për qëllime ushqimore, siç janë ushqimet për fëmijë. Nuk ka kufizime për lëngjet e futura në bagazhet e stivës. Burimi: ENAC.

Çfarë lejohet të merret në bord

Përsa i përket rregullave të sigurisë në lëndën e transportit të bagazhit të dorës, pasagjeri mund të konsultojë faqen e internetit ENAC dhe aty gjen gjithë informacionet e rëndësishme.

Fëmijët e mitur të pashoqëruar

Çdo kompani ajrore aplikon procedurat dhe rregulla vetjake sa i përket fëmijëve të mitur të pashoqëruar. Zakonisht fëmijët e mitur duhet të paraqitet me një shoqërues, i cili duhet të cilësohet si i tillë në momentin e pranimin dhe imbarkimit në avion. Shoqëruesi duhet të jetë gjithashtu një person madhor dhe nëse është njëri nga prindërit, kujdestari apo një subjekt tjetër që ushtron përgjegjësinë prindërore, duhet të disponoj prokurën e posaçme dhe dokumentet e udhëtimit për të njëjtën linjë si minoreni dhe të fluturojë në të njëjtin avion të pasagjerit të mitur që shoqëron. (Ryanair nuk parashikon transportin e fëmijëve të mitur të pashoqëruar - nën 16 vjeç - për çdo rast është e nevojshme të verifikohet në faqen e internetit të kësaj kompanie ajrore përpara se të procedohet me blerjen). Fëmijët e mitur nën 16 vjeç, duhet të jenë gjithnjë të shoqëruar nga një pasagjer tjetër, i cili duhet të jetë të paktën 16 vjeç. Nuk janë të disponueshme shërbime shoqërimi apo shërbime të tjera të veçanta.

Easy Market përgjigjet për mospërmbushjen e udhëtimit për shkak të mosrespektimit të rregullave në lëndën e imbarkimit të fëmijëve të mitur të pashoqëruar. Në çdo rast është përgjegjësi e pasagjerit të informohet lidhur me rregullat dhe procedurat specifike të aplikuara nga kompania me të cilën kërkohet të prenotohet apo është bërë prenotimi, dëme të mundshme apo shpenzime për mospërmbushje të rregullave në lëndën e imbarkimit, janë tërësisht në ngarkim të pasagjerit.

Në rast problematikash

Në rast problematikash mund t'i referoheni kartës së të drejtave të pasagjerit e cila mund të konsultohet pranë faqes së internetit ENAC.

TERMAT DHE KUSHTET: Hotele, Eskursione dhe Transferta

Easy Market vepron ekskluzivisht si ndërmjetësues produktesh dhe / apo shërbimesh.

Prenotimi dhe / apo kombinimi i hoteleve dhe produkte vetë ndryshme dhe / apo të ofruara nga **Easy Market** është në diskrecion të plotë të Agjencisë kliente, e cila merr çdo përgjegjësi që rrjedh nga kombinimi i tyre.

Shërbimi turistik i hotelerisë, ashtu si dhe eskursionet apo transfertat nuk kategorizohen si raste të negociueshme paketash turistike dhe për këtë arsye disiplinohen nga termat dhe kushtet e secilit shërbim objekt i kontratës, si më poshtë vijon:

Easy Market nuk përgjigjet në asnjë rast lidhur me gabimet në futjen e të dhënave personale nga ana e klientëve bërë gjatë procesit të blerjes.

Agjencia është përgjegjëse për pasojat që rrjedhin nga futja e gabuar e këtyre të dhënave.

Në fakt, në rastin e produktit HOTEL, Eskursione dhe / apo Transferta, **Easy Market** vepron në cilësinë e ndërmjetësit të furnizuesëve të ndryshëm të shitjes vetëm të fjetjes në hotel apo shërbimin shtesë.

Easy Market vepron si ndërmjetës produktesh dhe / apo shërbimesh edhe lidhur me shitjen e shërbimeve shtesë dhe facultative s.d. *activities* (psh. Guida turistike, spektakle, evente sportive, dhe rikreative në përgjithësi, shërbime restorantesh, kulturore etj.) c.d. *transfer*, të cilat blihen nga klienti përfundimtar veçmas dhe të cilat ofrohen drejtpërdrejt nga hoteli apo nga furniturore të tretë të këtij të fundit, sipas kushteve kontraktore të vendosura në skedën e blerjes dhënë nga Hoteli apo nga furniturore të tretë të këtij klienti final, duke qenë se nuk klasifikohen në rastet e negociueshme të organizimit të paketave turistike as si përgjegjësi e **Easy Market** në furnizimin dhe ekzekutimin e këtyre *activities* apo *transfer*.

Easy Market nuk përgjigjet në asnjë rast për detyrimet që janë barrë e furnitorëve të secilit product dhe / apo shërbim, por është përgjegjës ekskluzivisht për atë që rrjedhin nga cilësia e vet si ndërmjetës dhe gjithsesi në limitet e parashikuara nga ligji Nr. 93/2015 “Për turizmin”, ligj i cili është në përputhshmëri të pjesshme me nenin 2, nenin 3, si dhe me kuadri ligjor i Aneksit të

Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE të 13 qershorit 1990, “*Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve*”.

Easy Market në cilësinë e ndërmjetësuesit të udhëtimeve, nuk përgjigjet për mospërbushjen totale apo të pjesshme të udhëtimit, qëndrimit apo produkteve të tjera dhe / apo shërbimeve që janë object i kontratës së nënshkruar mes klientit dhe furnitorit lidhur me produktet dhe / apo shërbimet.

Ndryshimet dhe anulimet

Në rast se lind nevoja për ndryshime apo anulime të fjetjes në hotele dhe / apo shërbimeve shtesë (activities apo transfer), Agjencia duhet t’I drejtojë kërkesën kompanisë Easy Market duke dërguar një e-mail në adresën: hotel@easymarketers.it

Pasi bëhet ky komunikim, zyra kompetente do të verifikojë nëse për fjetjen në hotel, për eskursionin apo transfertën e blerë, lejohen ndryshime dhe / apo anulime.

Në rast se po sipas kushteve të kontratës, të vendosura në skedën e dhënë nga hoteli apo shërbimi në momentin e blerjes, do të komunikohen penalitetet e mundshme të aplikuara nga hoteli.

Rimbursimet

Nëse pagesa është bërë me anë të kartës së kreditit, shuma do të rimbursohet drejtpërdrejt në kartën e kreditit të përdorur për të bërë porosinë sipas llojit të pagesës së përdorur. Shuma do të jetë e disponueshme për tërheqje në 2/3 muajt pasardhës të kërkesës.

Nëse pagesa është bërë nëpërmjet bankës (e mundshme vetëm për Hotelet), Agjencia do të kontaktohet nga shërbimi ynë i klientit për komunikimin e koordinatave bankare për të kryer rimbursimin.

Dokumentat

Është detyrim i Agjencisë të sigurojë që klienti i saj të ketë me vete dokumentin e identitetit, vizat dhe kushtet shtëndetësore të vlefshme për të hyrë në vendet objekt të itinerarit.

Easy Market heq dorë nga çdo përgjegjësi për mospërbushje lidhur me mangësitë e tyre.

Në fazë prenotimi është gjithashtu e nevojshme të tregohet kujdes i veçantë edhe për plotësimin e hapësirave që lidhen me emrin dhe mbiemrin e pasagjerëve, që duhet të korrespondojnë saktësisht me ato që ndodhen në dokumentin e identitetit personal të klientëve.

Termit dhe kushtet: Qeradhënia e automjeteve

Easy Market informon Agjencinë të kryejë ekskluzivisht aktivitetin e ndërmjetësuesit për gjithë shërbimet e ofruara nëpërmjet këtij seksioni dhe për këtë qëllim e fton të lexojë me kujdes **KUSHTET E PËRGJITHSHME** të kësaj faqeje duke qenë se janë të aplikueshme. Ky shërbim turistik i qeradhënies së automjeteve nuk konsiderohet si rast i negociueshëm për organizimin e paketave turistike dhe për këtë arsye disiplinohet nga termit dhe kushtet e sejcilit shërbim objekt i kontratës si më poshtë vijon.

Easy Market vepron ekskluzivisht si ndërmjetës i produkteve dhe / apo shërbimeve.

Prenotimi dhe / apo kombinimi i qeradhënies së automjeteve dhe produkteve dhe / apo shërbimeve të ofruara nga **Easy Market**, është diskrecion tërësisht i Agjencisë, e cila merr çdo përgjegjësi që rrjedh nga kombinimi i tyre.

Easy Market nuk përgjigjet në asnjë rast për futjen e gabuar të të dhënave personale të përdoruesit, kryer gjatë procesit të blerjes. Agjencia është përgjegjëse për pasojat që rrjedhin nga futja e gabuar e këtyre të dhënave.

Gjatë fazës së prenotimit është gjithashtu e nevojshme të tregohet kujdes i veçantë edhe për plotësimin e hapësirave që lidhen me emrin dhe mbiemrin e pasagjerëve, që duhet të korrespondojnë saktësisht me ato që ndodhen në dokumentin e identitetit personal të klientëve.

Easy Market nuk përgjigjet në asnjë rast për detyrimet që janë barrë e furnitorëve të secilit produkt dhe / apo shërbim por është përgjegjëse ekskluzivisht për atë që rrjedhin nga cilësia e vetë si ndërmjetës dhe gjithsesi në limitet e parashikuara nga ligji Nr. 93/2015 “Për turizmin”, ligj i cili është në përputhshmëri të pjesshme me nenin 2, nenin 3, si dhe me kuadri ligjor i Aneksit të Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE të 13 qershorit 1990, “Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve” dhe Ligjin nr.9902, dt.17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar lidhur me të drejtat e konsumatorit, lidhur shërbimin e transportit të pasagjerëve.

Në rastin e produktit **AUTOMJET**, **Easy Market**, vepron si ndërmjetës mes kompanive të qeradhënies së automjeteve MicronNexus GmbH partner në ofrimin e shërbimit të qeradhënies së automjeteve dhe klientit.

FURNITORI I SHËRBIMIT TË QERADHËNIES SË AUTOMJETEVE

MicronNexus GmbH

Haus Am Domplatz

Buceriusstrasse 2, 20095

Hamburg, Gjermani

Easy Market nuk përgjigjet në asnjë rast për detyrimet që janë barrë e furnitorëve të sejcilit produkt dhe / apo shërbim por është përgjegjëse ekskluzivisht për ato që rrjedhin nga cilësia e vetë si ndërmjetës dhe gjithsesi në limitet e parashikuara nga ligji ligji Nr. 93/2015 “Për turizmin”, ligj i cili është në përputhshmëri të pjesshme me nenin 2, nenin 3, si dhe me kuadri ligjor i Aneksit të Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE të 13 qershorit 1990, “Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve” dhe Ligjin nr.9902, dt.17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

Easy Market në cilësinë e ndërmjetësuesit të udhëtimeve, nuk përgjigjet për mospërbushjen totale apo të pjesshme të udhëtimit, qëndrimit apo produkteve të tjera dhe / apo shërbimeve që janë objekt i kontratës së nënshkruar mes klientit dhe furnitorit lidhur me produktet dhe / apo shërbimet. Agjencia deklaron dhe garanton ta ruajë të pacënuar dhe të mos dëmtojë Easy Market, si dhe subjektet e lidhur me të dhe të kontrolluara prej saj, përfaqësuesit e saj, vartësit, bashkëpunëtorët, si dhe partnerët e saj nga çdo detyrim që kërkon dëmshpërblim, përfshirë shpenzimet ligjore, që mund të rrjedhin në ngarkim të saj, lidhur me përdorimin e produkteve / shërbimeve të blera në faqen e internetit.

Pagesa e shërbimit të qeradhënies së automjetit

Pagesa do të bëhet nëpërmjet faqes Revolution.travel për gjithë shumën e qeradhënies së automjetit. Kostoja e shërbimeve të mundshme të prenotuara më vete duhet të shlyhet në vend.

Dokumentet e nevojshëm për tërheqjen e një autoveture

Për të tërhequr një automjet është e nevojshme të paraqiten këto dokumente:

- **Kartë krediti e vlefshme gjatë prenotimit dhe në emër të personit që do të tërheqë automjetin**, me një shumë limit të mjaftueshme për të bërë pagesën. Nuk janë të vlefshme për këtë qëllim bankomatet apo kartat e debitit. Është e detyrueshme që personi që tërheq makinën të jetë po ai në emër të të cilit është bërë prenotimi. Nuk i lëshohen automjete atyre që nuk janë titullarë të kartës së kreditit.

- **Voucher lidhur me prenotimin e qeramarrjes së automjetit**, pasi bëhet prenotimi, do të dërgohet një e-mail konfirmues me kodin e prenotimit në adresën e postës elektronike të dhënë në fazën e prenotimit. Brenda dy ditësh pune, klienti do të marrë konfirmimin nga kompania qeradhënëse e automjetit.

Nga ky email mund të kontrollohet gjendja e prenotimit duke klikuar në një link, nga i cili do të hapet një faqe me Voucher-in që duhet printuar dhe dorëzuar në momentin e tërheqjes së automjetit.

- **Leje drejtimi automjeti e vlefshme**; ata që drejtojnë automjetin duhet të jenë në posedim të një leje drejtimi automjeti të vlefshme prej së paku një viti dhe nuk duhet të kenë kryer shkelje të rënda të Kodit Rrugor.
- **Një dokument identiteti të vlefshëm**

Easy Market nuk mban përgjegjësi për mospërbushje lidhur me mungesën e një prej dokumenteve të sipërpërmendur apo për paraqitjen e një dokumenti të pavlefshëm.